



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA			
INSTITUTI I HISTORISË - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU			
Njesia Org. Org. Unit.	1H	Nr. i prot. Prot. N.	01/128/23
Org. Jed.		Br. Prot.	
Nr. i Faqeve No. Pages	77	Data: Date:	09.06.23
Br. Stranica		Datum:	
PRISHTINË - A			



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 09.06.2023

RAPORTI I KOMISIONIT RECENSUES

*për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës:
Bashkëpunëtor i lartë shkencor për fundin e shek. XX- zgjedhje/rizgjedhje*

Bazuar në konkursin e Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, të shpallur më 20.05.2023 në të përditshmen "Epoka e Re" dhe faqen zyrtare të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë (neneve 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 si dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "Ali Hadri" nr. 01/50/20), si dhe bazuar në vendimin e datës 19.05.2023, Komisioni Recensues për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për fundin e shek. XX- zgjedhje/rizgjedhje*, në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Alban Dobruna - kryetar, Prof. Dr. Haki Kasumi - anëtar dhe Prof. Asoc. Dr. Emine Hajdari - anëtare, i paraqet Këshillit Shkencor këtë:

RECENSION

për kandidatin

Mbështetur në dokumentet dhe dispozitat ligjore mbi të cilat është shpallur konkursi i sipërshënuar si dhe në dosjen e kandidatit të paraqitur, Komisioni Recensues ka konstatuar se në konkursin për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për fundin e shek. XX - zgjedhje/rizgjedhje*, ka konkurruar vetëm Skender Zhitia.

Komisioni Recensues gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit, bazuar në dispozitat ligjore të kërkuara për këtë vend pune, në mënyrë të veçantë ka shqyrtuar punimet e publikuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike dhe revistat vendore, botime të monografive, pjesëmarrjen në sesione, konferenca, simpoziume, tryeza shkencore ndërkombëtare e kombëtare si dhe kontribute të tjera shkencore dhe profesionale të kandidatit nga thirrja e fundit.

TË DHËNA BIOGRAFIKE PËR KANDIDATIN

Kandidati Skender Zhitia u lind më 04.04.1964 në fshatin Lluga, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës. Studimet universitare i vijoi në Universitetin në Prishtinë, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë, ku u diplomua në vitin 1990. Studimet pasuniversitare i vijoi po në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë, periudha bashkëkohore. Në vitin 2007 mbrojti punimin e magistraturës “*Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Zona Operative e Llapit*”. Studimet e doktoratës po ashtu i vijoi në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë, gjatë viteve 2013-2019. Në vitin 2019 mbrojti tezën e disertacionit të doktoratës me temë “*Roli i Mbrojtjes Civile në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës 1998-1999*”. Nga 7 tetori i vitit 2019, Skender Zhitia punon në Institutin e Historisë “*Ali Hadri*” në Prishtinë si *Bashkëpunëtor shkencor për fundin e shek. XX*. Skender Zhitia, sipas konkursit i ka ofruar të gjitha dëshmitë për të dhënat e ofruara në CV-në e tij.

AKTIVITETI KËRKIMOR-SHKENCOR DHE PROFESIONAL

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, neni 5, përkatësisht **Shtojcës I, pika A.2.1**, punimet e publikuara në revista ndërkombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike me 1 **dhe pika A.2.2**, punimet e publikuara në revista kombëtare, të cilat janë të barasvlershme me 1, Skender Zhitia ka këto punime të publikuara:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Titulli i punimit	Revista	Vëll.nr.(viti), fq.	Linku i publikimit
1.	Skender Zhitia	“The beginnings of the organization of the Kosovo Liberation Army in the Lap Operation Subzone December 1995- June 1998”,	<i>Anglisticum Journal,</i>	volume 10, Issue 1, 2021 fq. 10-25	http://www.anglisticum.org.mk .
2.	Skender Zhitia	“The Anti-Albanian Policy of the Serbian State, Programs and Methods (XIX-	<i>Jurnal of Hystori&Future,</i>	Volume 7, Issue 2, 2021. fq.691-710	https://dergipark.org.tr/en/pub/jhf .

		XX)",			
3	Skender Zhitia	"Beteja e Llapashticës (24-27 dhjetor 1998) – Version i memoareve të luftëtarëve të Zonës Operative të Llapit"	Kosova	Nr.47, 2023, Fq. 171-190	https://ih-rks.org/

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika A. tabela 1.2**, publikimet e monografive studimore, librave me dokumente, në gjuhën shqipe, Skender Zhitia ka të botuar dhe ribotuar këto studime monografike:

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.	Skender Zhitia	"Mbrotjtja Civile në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës-Zona Operative e Llapit".	Libër monografik	Instituti i Historisë "Ali Hadri"	Prishtinë, 2020.
2.	Skender Zhitia	"Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Zona Operative e Llapit"	Libër monografik (Ribotim)	Instituti i Historisë "Ali Hadri"	Prishtinë, 2023.

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht **Shtojcës II, pika B. tabela 1.1**, publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel ndërkombëtar (brenda dhe jashtë vendi), Skender Zhitia ka të publikuara ose janë në proces të publikimit:

Nr.	Autori/autorët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumet	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), fq.
1.	Skender Zhitia	The role of the International Community in resolving the Kosovo issue (1998-1999)	International Conference on Social and Natural Sciences, Lisbon – Portugal.	International Institute for Private, Commercial and Competition Law) Lisbon-Portugal.	ICSNS XIX – 2021 Fq. 27-38

2.	Skender Zhitia	Gruaja shqiptare simbol i lirisë së Kosovës - Zona Operative e Llapit	Konferencë ndërkombëtare “Roli i grave në jetësimin e shtetit të Kosovës (Aspekte sociale, kulturore, politike nga viti 1980 dhe deri në ditët e sotme)”. Organizuar nga Instituti i Historisë, Prishtinë dhe Instituti i Historisë – Tiranë.	Kumtesa përcillet për botim sipas afateve të caktuara nga IH “Ali Hadri” - Prishtinë	Prishtinë, 2023
----	----------------	---	--	--	-----------------

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht Shtojcës II, pika B. tabela 1.2, publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel vendor, Skender Zhitia ka të publikuara ose janë në proces të publikimit:

Nr.	Autori/ autorët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), fq.
1.	Skender Zhitia	Demonstratat e vitit 1981 dhe kundërvënia serbo-jugosllave	Konferenca shkencore kushtuar 40 vjetorit të Demonstratave të vitit 1981. Organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë dhe nga Akademia e studimeve Albanologjike Instituti i Historisë – Tiranë, Prishtinë, 10 qershor 2021	Instituti i Historisë-Prishtinë	Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, Instituti i Historisë, 2021. Fq. 43-58
2.	Skender Zhitia	Organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.	Sesioni shkencor, Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Vlerë Kombëtare. Organizuar nga Instituti Albanologjik-Prishtinë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencioni Shtetror e Arkivave të Kosovës. Prishtinë, 7 mars	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	Vëllimi i kumtesave nga Sesioni shkencor, UÇK, vlerë kombëtare, A ShA të Kosovës, 2022. Fq. 223-

			2022		231
3.	Skender Zhitia	Krimet e forcave serbe në komunën e Prishtinës, Podujevës, Obiliqit dhe të Fushë Kosovës (1998-1999)”	Konferencë shkencore, Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX. Organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë, Instituti i Historisë – Tiranë dhe Instituti Albanologjik – Prishtinë, 7-8 prill 2022	Në proces të botimit nga IH “Ali Hadri”- Prishtinë	
4.	Skender Zhitia	Binomi UÇK-popullsi civile faktor jetik gjatë luftës në Kosovë (1998-1999)	Sesioni shkencor, Kosova 15 vjet shtet. Organizuar nga Instituti i Historisë “, Prishtinë, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Instituti i Historisë – Tiranë dhe Institutin për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. 15 shkurt 2023	Në proces të botimit nga IH “Ali Hadri”- Prishtinë	

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesvë, përkatësisht **Shtojcës II, pika C. tabela 1.3**, redaktor, recensues, anëtar redaksie në revista akademike dhe shkencore, Skender Zhitia ka këto kontribute:

Nr.	Kontributi (redaktor, recensues...)	Autori origjinal i librit	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recension	Vendi dhe viti
1.	Redaktor		<i>Kosova</i>	Prishtinë, 2023

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht Shtojcës II, pika C. tabela 1.4, kontribute të tjera shkencore dhe profesionale, Skender Zhitia ka këto kontribute:

Nr.	Autori/autorët	Lloji i kontributit shkencor	Vendi dhe viti
1.	Skender Zhitia	Kryetar i Komisionit Recensues për vendin e punës <i>Bashkëpunëtor shkencor për periudhën e shek. XX-zgjedhje/rizgjedhje.</i>	Prishtinë, 2022
2.	Skender Zhitia	Anëtar i Komisionit Recensues për vendin e punës <i>Bashkëpunëtor shkencor për shek. XX- zgjedhje/rizgjedhje.</i>	Prishtinë, 2022

Sipas Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve, përkatësisht Shtojcës II, pika D. tabela 1.1, pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve shkencore, Skender Zhitia ka këto kontribute të tjera shkencore dhe profesionale:

Nr.	Programi/projekti shkencor	Periudha kohore	Pozicioni në projekt	Institucioni dhe vendi
1.	Historia e Kosovës	Në proces	studiues	Instituti i Historisë-Prishtinë
2.	Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX	Në proces	studiues	Instituti i Historisë-Prishtinë

KONKLUZION

Mbështetur në dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet e konkursit, të shpallur më 20.05.2023, në të përditshmen "Epoka e Re" dhe faqen zyrtare të Institutit të Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, si dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), në Statutin e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë dhe Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "Ali Hadri", Komisioni Recensues ka arritur në këtë konkluzion:


Marrë në konsideratë rezultatet e punës shkencore, përgatitjen adekuate mbi periudhën e kërkuar në konkurs, punimet shkencore të fushës përkatëse të botuara në revista relevante, botimin dhe ribotimin e monografive shkencore, pjesëmarrjen në aktivitete, konferenca e tryeza shkencore brenda e jashtë vendit, kontributet shkencore si dhe përvojën e krijuar brenda Institutit të Historisë "Ali Hadri", Komisioni Recensues ka arritur në përfundimin se kandidati Prof. Ass. Dr. Skender Zhitia ka të arritura dhe kontribute shkencore të profilizuara për periudhën e caktuar, kualifikimin dhe përvojën e duhur, që i mundësojnë zgjedhjen dhe vazhdimin e marrëdhënies së punës sipas pozitës së kërkuar në konkurs.

PROPOZIM


Komisioni Recensues, bazuar në kushtet e konkursit, kriteret ligjore dhe të arritura profesionale, për vendin e punës **Bashkëpunëtor i lartë shkencor për fundin e shek. XX** në Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, propozon kandidatin Prof. Ass. Dr. Skender Zhitia.

Komisioni Recensues:

Prof. Asoc. Dr. Alban Dobruna, *kryetar*



Prof. Dr. Haki Kasumi, *anëtar*



Prof. Asoc. Dr. Emine Hajdari, *anëtare*

